



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 61 Prot.

Tiranë, më 15.01 2019

VENDIM Nr. 7, datë 15.01.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1, datë 15.01.2019, pasi shqyrtoi Raportin e i Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC KEBELA" Bashkia Gramsh*-subjekti "OSMANI" sh.p.k. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e i Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "HEC KEBELA" Bashkia Gramsh*-subjekti "OSMANI" sh.p.k. realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Neritan Ceka.
2. Bazuar në nenin 146, pika 1, të ligjit 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", "Personat, të cilët gjatë punimeve bujqësore apo ndonjë fakti çfarëdo ndeshin gjetje rastësore, sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 144, të këtij ligji, kanë detyrimin të deklarojnë me shkrim, brenda tri ditëve, tek organet e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore". Gjithashtu ata duhet të kryejnë procedurën e plotë të cituar në këtë nen, pasi në të kundërt sipas pikës 6 të këtij neni "Mosraportimi në organet kompetente, në kundërshtim me këtë nen, përbën shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat përgjegjës".
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al